



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 388/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër të dhënavë të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 26.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.06.2014, nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, ku pretendon se sipas të dhënavë që posedon shtabi zgjedhor i AAK-së dega në Prishtinë të marra nga zyrtarët në vendvotime nuk janë evidentuar saktë votat e qytetarëve të Prishtinës për AAK-në të prezantuar në faqen zyrtare të KQZ-së, duke pretenduar se ka ndryshime votash në dëm të kandidatëve dhe të subjektit politik në fjalë. Parashtuesi i ankesës thekson se subjektit politik në fjalë i mungojnë 136 vota dhe ka paraqitur numrin e votave që i mungojnë për secilën QV si më poshtë: 1903E/05r -35 vota; 1904E/05r – 35 vota; 1913E/01r – 26 vota; 1917E/06r – 38 vota; 1917E/07d – 15 vota; 1920X/03r – 13 vota; 1921E/02r – 11 vota.

Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur formularët e zyrtarëve të AAK-së, të dhënat e marra nga ueb faqja zyrtare e KQZ-së, dhe deklaratat e komisionarëve të të këtij subjekti politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjt për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmッシュin standardet*” dhe Nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “*PZAP-i, mund ti hedh poshtë (si te palejuara, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore*”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 388/2014 më datën 26.06.2014



Këshillë juridike: *PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*